



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

QENDRËS "A.L.T.R.I"


Palët:

Ky memorandum lidhet midis :

Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i njohur më poshtë si "K.M.D", i përfaqësuar nga Komisioneri Znj. Irma Baraku dhe që është institucion shtetëror i pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me qëllim mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Dhe


Albanian Legal and Territorial Research Institute regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jo-Fitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 715 më date 16.12.2011 njohur më poshtë si Qendra "A.L.T.R.I" përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Znj. Eda Noçka, me adresë Rr "Asim Zeneli" Nr. 15, Tiranë



Neni 1 Rëndësia

MEQENËSE:

1. Në kuadër të ligjit organik nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", është krijuar institucioni i KMD-së, si person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe si autoriteti përgjegjës i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.
2. Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin, monitorimin e zbatimit të këtij ligji, adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.
3. Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë: (i) nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; (ii) adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; (iii) informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; (iv) zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe (v) zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.
4. Prioritetet strategjik kryesore të KMD-së, për t'u realizuar deri në vitin 2015, janë: (i) rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë; (ii) rritja e numrit të ankesave drejtuar KMD-së (iii) organizimi i përshtatshëm institucional me qëllim rritjen e efikasitetit të KMD-së (iv) konsolidimi i rolit të KMD-së në sektorin publik dhe privat.
5. Në kuadër të objektivit strategjik "*Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë*", Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi ka si objektiv specifik arritjen e një niveli bazë ndërgjegjësimi të publikut në përgjithësi, si dhe Konsolidimin i rolit të KMD-së në sektorin publik.
6. Qendra "A.L.T.R.I." është një organizatë me karakter shkencor, kërkimor, profesional, kulturor, e pavarur, joqeveritare dhe jopolitike.
7. Sipas statutit dhe aktit të themelimit të ALTRI, Qendra gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj kërkon të arrijë: (i) kërkimin, studimin, sensibilizimin, advokimin dhe lobimin për çështje ligjore dhe sociale; (ii) luajtjen e një roli ndërmjetësues midis autoriteteve publik edhe publikut me qëllim adresimin e nevojave të publikut dhe rritjes së besimit



tek zyrtarët publikë, si dhe (iii) nxitjen dhe krijimin e forumeve konstruktive për shkëmbimin e ideve dhe informacionit midis aktorëve kryesorë dhe grupeve të interesit në procesin e formulimit të politikave në çështjet ligjore dhe sociale.

8. Qendra "ALTRI" në kuadër të veprimtarisë së saj ushtron në mënyrë të vazhdueshme projekte apo iniciative në fushën kundër diskriminimit.
9. Këto iniciativa kanë për qëllim të përgjithshëm kontribuimin për luftimin e diskriminimit për shkaqe të ndryshme përmes informimit, sensibilizimit, ushtrimit të presionit pozitiv dhe studimit të diskriminimit në funksion të promovimit të të drejtave të grupeve të diskriminuara, duke kontribuar kështu në promovimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

ATEHERE, meqenëse ekzistojnë parashtrimet si me sipër, palët bien dakord dhe lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi me kushtet si me poshtë:

Neni 2 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi bashkëpunimi është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet K.M.D dhe Qendrës "A.L.T.R.I" me qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit në kuadrin e punës së përbashkët dhe garantimit të realizimit të misioneve të përbashkëta vëzhguese në organet e administrates publike, zhvillimit të politikave dhe ligjeve në favor të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, luftës për eliminimin e diskriminimit për shkak të moshës, statusit, gjinisë, fesë, si dhe për avancimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, përfshirë ndër të tjera edhe avancimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, të minoriteteve dhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Neni 3 Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord si më poshtë:

1. Institucionalizohet, sipas këtij memorandumi dhe akteve të tjera të nevojshme të pranuar nga palët, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve të ndërsjellta për shkëmbimin e informacioneve, vënies në dispozicion të Qendrës "A.L.T.R.I" nga ana e "K.M.D", të informacioneve/të dhënave të cilat zotëron ky institucion si dhe të bashkëpunojë gjatë realizimit të këtij projekti, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të cilat do të ndërmerren në të ardhmen.
2. "KMD" dhe Qendra "A.L.T.R.I" angazhohen të bashkëpunojnë me njëri tjetrin, në kuadër të realizimit të aktiviteteve. Marrëveshja do të zbatohet midis palëve të lartëpërmendura, në fushën e kësaj marrëveshje për të përmbushur objektin e saj.



3. Kjo marrëveshje do të konsistojë në:

- a) Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit me fokus diskriminimin dhe mbrotjen e të drejtave të njeriut në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat e ratifikuara nga shteti Shqiptar në fushën e diskriminimit.
- b) Referimin e rasteve konkrete, sipas nevojave të ankuesit/es, përfshirë edhe referimin e rasteve të ndërsjelltë midis Qendres "A.L.T.R.I" dhe institucionit të KMD.
- c) Marrjen e iniciativave të përbashkëta për adresimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete, pranë organeve kompetente e gjykatave kombëtare, gjykatës Kushtetuese, si dhe organeve përkatëse ndërkombëtare.
- d) Angazhimin e organizatës për të informuar KMD për çështjet dhe problematikat, si dhe përgjithësimet e dala nga raportet monitoruese, në lidhje me çështjet e mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, për sa i përket çështjeve të diskriminimit.
- e) Shkëmbimin e rregullt të informacionit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike, shkëmbimit të informacionit, vizitave të përbashkëta në terren, njoftimeve reciproke për raste të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje.
- f) Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuere në nivel kombëtar, përfshirë edhe organizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut.

Neni 4 Komunikimi

Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit. Në rastet e shmangies nga rregullat, detyrimet dhe procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5 Ndryshime

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.



Neni 6
Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum.

Neni 7
Shfuqizimi i akteve



Çdo marrëveshje e mëparshme e lidhur mes palëve që vjen në kundërshtim me këtë Memorandum, shfuqizohet.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi, hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale.

Tiranë, më 19/12/2012.


Irma Baraku
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi


Eda Noçka
Drejtoreshë Ekzekutive


Prot. N° 502
19.12.2012